



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË

Nr. 34 Prot.

Pukë, më datë 31.10.2022

Lënda: Njoftim mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në pozicionin “Specialist arkive”, kategoria ekzekutive.

Drejtuar: Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Adresa: Godina “Poli i Drejtësisë”, Rr. ‘Ana Komnena’, Tiranë.

Në zbatim të Ligjit Nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit Nr.622 datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjenparalele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira nëshërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor" si dhe shpalljen nr. 327 datë 17.10.2022 të Gjykatës Rrethit Gjyqësorë Pukë, ju njoftojmë se:

Në përfundim të verifikimit paraprak, për përmbushjen e kriterëve, në lidhje me procedurën e lëvizjes paralele në pozicionin “Specialist arkive” nuk u paraqit asnjë kandidaturë.

Procedura e lëvizjes paralele mbyllet për mungesë aplikimi dhe vendi vakant është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

Kancelare
Valbona SULEJMANI

